

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7842
E martë, 23 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Haga duhet të korrigojë, të kërkojë falje | PAGE 4



Shkruan: Sali BISLIMI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



VETURAT E GRUPIT TË RADOIÇIQT TANI NË PËRDORIM NGA POLICIA E KOSOVËS F. 3

KËSHILLI I BE-së MERR VENDIM PËR T'UA HEQUR VIZAT SERBËVE TË KOSOVËS F. 7

PËR NJË JAVË ZYRTARËT POLICORË TË RAJONIT TË PRISHTINËS REALIZUAN 253 URDHËRESA TË GJYKATËS F. 6

EKONOMI



TURIZMI NË SHOIPËRI: MANGËSI NGA BRENDA APO SULME NGA JASHTË F. 8

ATK-ja NË AKSION, BIZNESET KONTROLLOHEN PËR KUPONË FISKALË DHE REGJISTRIM TË PUNËTORËVE F. 8

SPORT



LIGA E KONFERENCËS: BALLKANI, DRITA DHE LLAPI MËSOJNË KUNDËRSHTARËT PËR RRETHIN E TRETË F. 10

14 VJET NGA VENDIMI I GJND-së, POZITË E OPOZITË THONË SE ISHTE NJË NGA MOMENTET MË TË RËNDËSISHME TË SHTETËSISË DHE SHTETNDËRTIMIT TË KOSOVËS



Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë konstatoi se shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të Drejtën

Ndërkombëtare. Ky vendim e vulosi përfundimisht të drejtën e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Për këtë vendim kanë

reaguar të hënën pozita dhe opozita, duke vlerësuar se ishte një nga momentet më të rëndësishme të shtetësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës

GIFT: GARA MES TRUMPIT DHE HARRISIT DO TË ISHTE E NGUSHTË F. 5



NJË DELEGACION I MJEKËVE NGA TURQIA DO TË REALIZOJË 50 OPERACIONE TË FËMIJËVE NË KOSOVË ME PROBLEME NË BUZË DHE HUNDË F. 2

RENOVA
Maqedoni PUTZ
Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Gift: Gara mes Trumpit dhe Harrisit do të ishte e ngushtë

WASHINGTON, 22 KORRIK - Gara presidenciale në ShBA mes republikanit Donald Trump dhe demokrates Kamala Harris - nëse kjo e fundit konfirmohet - do të jetë e ngushtë, thotë Thomas Gift, drejtor i Qendrës për politikën amerikane në Kolegjin Universitar të Londrës. Në një intervistë dhënë Radios Evropa e Lirë, ai thotë se rezultati do të varet nga një përqindje e vogël votash në shtetet si: Ohajo, Pensilvania, Miçigjeni, Uiskonsini, Xhorxhia dhe Arizona. Presidenti aktual, Joe Biden, njoftoi më 21 korrik se tërhiqet nga gara e nëntorit, duke i dhënë mbështetje zëvendësues së tij, Kamala Harris.

Nga tabori republikan, ish-presidenti Donald Trump pranoi nominimin javën e kaluar, ndërsa Konventa e Partisë Demokratike, ku do të konfirmohet kandidati/ja demokrat/e, do të mbahet në gusht.

Cili është reagimi juaj pas dorëheqjes së presidentit Biden nga gara për rizgjedhje?

Thomas Gift: Isha i befasuar që Biden u tërhoq, por, nëse i shohim gjërat në retrospektivë, mbase nuk do të duhej të isha. Biden ishte në një pozitë të keqe. Sa herë që një anëtar i Kongresit bënte thirrje që të tërhiqej, ai dëmtonte në sondazhe. Sa herë që kërkohej dorëheqja e tij, ai thoshte jo dhe kështu vazhdonte rrethi vicioz. Kjo, thjesht, nuk do të ishte e qëndrueshme për një kohë të gjatë. Biden po bënte dy luftëra në të njëjtën kohë - një kundër Donald Trumpit dhe Partisë Republikane dhe një kundër Partisë së tij Demokratike. Do të ishte e tepërt që fushata zgjedhore të vazhdonte kështu.

Sa është domethënëse që ai nuk po largohet nga posti i presidentit?

Thomas Gift: Mendoj se është domethënëse, por, në të njëjtën



kohë, nuk është për t'u habitur. [Dorëheqja nga posti i presidentit] do të ishte vërtet një hap shumë larg për Bidenin. Dhe, natyrisht, republikanët do të flasin vazhdimisht për këtë deri në zgjedhje. J.D. Vance [kandidati republikan për nënpresident] ka pyetur nëse Biden mund të thotë se është i aftë për ta udhëhequr vendin edhe për katër ose pesë muajt e ardhshëm, nëse nuk është i aftë për të garuar në zgjedhje. Kjo është një pyetje e arsyeshme për t'u bërë, por mendoj se do të zbehet, në krahasim me disa çështje të tjera që do të lindin.

A është rruga e Harrisit drejt nominimit tani e thjeshtë dhe e qartë?

Thomas Gift: Mendoj se po, marrë parasysh që Biden e mbështeti Harrisin. Ka pasur shumë pyetje nëse ai, thjesht, do ta linte këtë çështje të rridhte dhe ta merrte drejtimin në konventë [të Partisë Demokratike]. Por, ka pasur edhe shqetësime se do të dukej keq për demokratët. Këto javët e

fundit kanë qenë mjaft të këqija për demokratët. Gjëja e fundit që do t'u duhej, do të ishte një konventë vërtet e mavijosur. Kështu që mendoj se Biden ka vepruar mirë që ka mbështetur Harrisin. Disa nuk do të jenë të lumtur për këtë, por ai ka qenë i nominuari i supozuar dhe, sigurisht, është në prerogativën e tij të thotë se kush mendon se do të ishte pasardhësi i tij më i mirë.

Si e shihni garën presidenciale Trump-Harris, nëse do të jetë me tyre?

Thomas Gift: Mendoj se do të jetë një garë e ngushtë. Do të ishte e ngushtë nëse Biden do të qëndronte në garë, mendoj se do të jetë e ngushtë nëse Harris do të jetë kundërshtar e Trumpit. Nëse i shikoni vetëm sondazhet, kohëve të fundit, Kamala Harris ka dalë pak më mirë se Bideni në përballjen me Trumpin. Por, kjo mund të ketë ndodhur edhe për faktin se Biden i ka pasur disa javë ku gjithçka dukej se po shkonte keq. Por, në fund, fituesi do të përcaktohet nga një

përqindje e vogël votash, në një numër relativisht të vogël të shteteve, si: Ohajo, Pensilvani, Miçigjen, Uiskonsin, Xhorxhia, Arizonë... Të dyja palët do të aktivizohen dhe do të shohim se si do të përfundojë.

A do të ishte gara Trump-Harris ndryshe nga ajo Trump-Biden?

Thomas Gift: Nuk e di nëse kjo e ndryshon rrënjësisht dinamikën e garës. Trump nuk ka qenë kurrë një nga ata që ka bërë përpjekje ta zgjerojë rrethin e tij të mbështetjes. Ai ka qenë gjithmonë i interesuar ta aktivizojë bazën e tij dhe të sigurohet që votuesit e tij kryesorë dalin në votime. Mendoj se do të përfshihet në shumë sulme të ashtuquajtura 'ad hominem'. Jemi, ndoshta, në një sezon shumë të keq të fushatës, por ky është një lloj realiteti i politikës amerikane tani. Ndoshta do ta shihnim të njëjtin edhe sikur Biden të mbetej në garë.

Cila mendoni se është trashëgimia e Bidenit nëse mund

të flitet për të në këtë fazë?

Thomas Gift: Mendoj se Biden e çimenton trashëgiminë e tij me tërheqjen nga gara. Do ta vinte në rrezik nëse do të garonte për rizgjedhje. Tani, ai mund ta kthejë kokën pas dhe të thotë se ka pasur sukses në mposhtjen e Donald Trumpit, se ka shtyrë përpara disa ligje të vështira, se ka udhëhequr ShBA-në gjatë pandemisë dhe më pas ia ka kaluar pishtarin brezit të ardhshëm. Mendoj se trashëgimia e tij, ndoshta, do të ishte edhe më e mirë, nëse do të jepte dorëheqje disa muaj më parë, por nuk e ka bërë këtë dhe kështu janë gjërat... Tani duket sikur është dëbuar. Por, në të njëjtën kohë, unë mendoj se ai mund të jetë krenar për atë që ka arritur. Ai ka pasur vërtet një karrierë të jashtëzakonshme në politikë, jo vetëm si president dhe nënpresident, por edhe në Senat. Ai ia ka kushtuar jetën vendit të tij. Mendoj se duke e kaluar pishtarin, ai ka bërë gjënë e duhur, ka bërë gjithçka që Partia Demokratike dhe Amerika mund t'i kërkonin.

Ministria e Shëndetësisë në Gazë: Numri i viktimave shkon në mbi 39.000

GAZA, 22 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë në Gazë tha se fushata ushtarake e Izraelit në këtë territor deri më tani ka lënë të vranë më shumë se 39.000 palestinezë dhe janë plagosur më shumë se 89.800 të tjerë. Numri i ri i viktimave vjen

teksa sulmet ajrore izraelite goditën jugun e Gazës dhe pjesë të tjera të territorit, duke vranë dhjetëra persona, tha ministria. Ministria e Shëndetësisë në Gazë nuk bënë dallimi mes civilëve dhe luftëtarëve të vranë në luftën mes Izraelit dhe Hamasit - grupit

palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor, pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit duke vranë afër 1.200 persona dhe duke rrëmbyer 250 të tjerë.



Haga duhet të korrigojohet, të kërkojë falje



Shkruan: **Sali BISLIMI**,
drejtor i OJQ "Zëri Perëndimor i
Kosovës" dhe drejtor i zyrës
ligjore *First-consulting.ch* në
Bern dhe Delémont të Zvicrës

Si është e mundur të tolerohet paragjykimi ose ofendimi që Haga krahason UÇK-në si organizatë terroriste, kjo UÇK që u mbështet ushtarakisht nga forcat ushtarake të NATO-s, si një fakt i pakontestueshëm kundër spastrimit etnik të kryer nga Serbia në Kosovë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, veçanërisht gjykatësi Jonas Nilsson, konsideron se UÇK-ja përbënte një organizatë kriminale, veçanërisht në lidhje me pohimet e tij gjatë gjykimit të Pjetër Shalës.

Ky qëndrim është vërtet i habitshëm për luftën (jus ad bellum). Kombet e Bashkuara (neni 51; vetëmbrojtja) motivuan pikërisht ndërhyrjen

e forcave të armatosura të NATO-s për të çliruar Kosovën nga zgjedha serbe të mbështetura në aktet e tyre të vetëmbrojtjes nga anëtarët e NATO-s dhe Bashkimit Evropian dhe Karta e Kombeve të Bashkuara.

A duhet ta shohim këtë si një volte-face apo një përmbyse në jurisprudencën e dhomave të specializuara?

Gjyqtarët e Hagës do t'i këshilloja në të ardhmen që të gjykojnë në mënyrë objektive aktet kriminale të kryera individualisht dhe jo të abuzojnë me Ushtrinë Çlirimtare.

UÇK me veprimin e saj kontribuoi ligjërisht në çlirim dhe njohjen de facto dhe de jure të Kosovës dhe shtet i së drejtës. Haga nuk guxon që UÇK-në si partnere të NATO-s ta barazojë me Hamasin.

Kjo lloj drejtësie nuk bën paqen por nxit luftën!

Veturat e grupit të Radoiçiqit tani në përdorim nga Policia e Kosovës

PRISHTINË, 22 KORRIK - Veturat që ishin përdorur nga grupi terrorist i Milan Radoiçiqit, në sulmin e shtatorit të kaluar, tashmë janë në përdorim nga institucionet tona. 34 veturat që ishin konfiskuar, tashmë i kanë kaluar njësisë të ndryshme të Policisë së Kosovës.

Gjithçka që kishin pasur me vete, terroristët pjesë e grupit që udhëhiqej nga Milan Radoiçiqi kishin lënë prapa derisa po iknin nga Kosova, më 24 shtator të vitit të kaluar. Përveç arsenalit të jashtëzakonshëm të armëve e municionit, prapa mbetën edhe 34 vetura të përdorur nga ta, duke përfshirë edhe vetura të blinduara.

Të njëjtat, nuk do të mbeten pa u shfrytëzuar.

Në fakt, tashmë ato janë në posedim të Policisë së Kosovës, dhe i janë ndarë njësisë të ndryshme.

Këtë e kanë konfirmuar edhe vet ky institucion në një përgjigje për televizion. "Policia e Kosovës ne te gjitha rastet dëshmitë/provat e konfiskuara



përfshirë automjetet i trajton sipas kompetencës ligjore në bashkëpunim dhe koordinim me organet e drejtësisë. Pas përfundimit të procedurave të parapara ligjore, në baze të vendimit të gjykatës kompetente

dhe Agjencisë për administrimin e pronave të sekuestruara dhe konfiskuara, automjetet iu dedikohen institucioneve shtetërore sipas nevojës, përfshirë edhe Policisë së Kosovës", thuhet nga ana e

PK-së.

Kjo gjë i është mundësuar Policisë e institucioneve tjera ndërmjet një ndryshim-plotësimi të ligjit përkatës të cilin e shpjegon avokati, Asdren Bytyqi. "Pas plotësim-

ndryshimit të ligjit për administrimin e pasurisë së konfiskuar ka të drejtë agjencia për administrimin e këtyre pasurive që të njëjtat të ja jep Qeverisë në shfrytëzim sipas kërkesave të saj, po ashtu edhe dikastereve qeveritare apo edhe agjencive", ka theksuar Bytyqi në RTV Dukagjini.

Pos këtyre veturave që koston nuk e kanë dhe aq të vogël, pasi përfshinte mes tjerash edhe vetura të blinduara, në shtator të vitit të kaluar në Banjskë ishte konfiskuar edhe mbi 50 predha minahedhëse 82 milimetërsh, mbi 60 të tjera predha minahedhëse 82 mm, 75 granata dore, 8 mina anti-tank, 150 copë eksploziv dinamit e shumë municion tjetër ushtarak.

Edhe pas aksionit, Policia në disa lokacione të ndryshme në veri kishte zbuluar depo me armë e municion të shumtë, që besohet se ishte shfrytëzuar nga grupi i Radoiçiqit, i cili megjithëse mori përgjegjësinë për sulmin terrorist, vazhdon të jetë i lirë në Serbi.

Szunyogu te Kurti në takim lamtumirës: Kosova t'i përshpejtojë reformat për rrugën drejt BE-së

Prishtinë, 22 korrik- Kryeministri Albin Kurti ka mirëpritur në takim lamtumirës shefin e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog.

Në një bisedë të hapur e miqësore, kryeministri Kurti falënderoi ambasadorin Szunyog për bashkëpunimin e mirë dhe për përfshirjen dhe kontributin e tij përgjatë gjithë mandatit në diskutimet e brendshme dhe ato publike.

Kryeministri veçoi dorëzimin në

vitin 2022 të aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, liberalizimin e vizave në vitin 2024, nivelin e lartë të përmbushjes së Agjendës e Reformave Evropiane (ERA 2) dhe vlerësimet pozitive në raportin e vendit për vitin 2022, si disa prej arritjeve të Kosovës në fushën e integritimit evropian, lëvizjes së lirë dhe reformave evropiane që janë shënuar gjatë mandatit të ambasadorit Szunyog.

U theksua gjithashtu

bashkëpunimi i mirë dhe mbështetja e rëndësishme e Bashkimit Evropian për Kosovën në ballafaqim me pandeminë Covid-19 dhe në tranzicionin energjetik.

Kryeministri Kurti i uroi ambasadorit Szunyog suksese në angazhimet e tij të radhës. Ambasadori Szunyog mori detyrën e shefit të zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së më 1 shtator 2020.





14 vjet nga vendimi i GjND-së, pozitë e opozitë thonë se ishte një nga momentet më të rëndësishme të shtetësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 22 korrik - 14 vite më parë, bazuar në një kërkesë për mendim këshillëdhënës të parashtruar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e vulosi në mënyrë të pakthyeshme ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se në 123 paragrafë të përmbledhur në 54 faqe vendim, Gjykata e arsyetoi gjerësisht se si Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 nuk shkelte asnjë normë të përgjithshme a speciale të së drejtës ndërkombëtare dhe se shkëputja e Kosovës nga shteti pararendës përbente tashmë një fakt të parevokueshëm. "Ky mendim këshillëdhënës gjithashtu e ndryshoi të paktën formalisht rrjedhën e dëmshme

për popullin shqiptar, meqenëse okupimi i Kosovës më 1912, mandej kolonizimi, diskriminimi e deri te gjenocidi në vitet 1998 e 1999, janë krime për të cilat asnjëherë nuk pati drejtësi ndërkombëtare e zhdëmtim për popullin e Kosovës. Është për të ardhur keq që në dekadën e kaluar ky mendim i GjND-së më së shumti u përmend te fusnota që iu mbivendos emërtimit të Kosovës, e nuk u përdor mjaftueshëm për ta përmbysur e eliminuar strategjinë e Serbisë për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të Kosovës përmes kornizës së dikurshme të Dialogut të Brukselit", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Ai ka thënë se mendimi Këshillëdhënës i GjND-së përbën një rast të rrallë ku gjykata mbështet pa asnjë dyshim e me një interpretim thellësisht të bindshëm lindjen e të drejtës së një populli të

shtypur e të kolonizuar për dekada me radhë nga një pushtet shovinist, kriminal e gjenocid-bërës, për të qenë dhe ekzistuar si shtet i pavarur e i ligjshëm në të drejtën ndërkombëtare. "Ndikimi i Mendimit Këshillëdhënës të GjND-së ishte dhe vazhdon të jetë i madh. Ajo përbën një fakt konstitutiv, të pakontestuar, të argumentit se qenia dhe vazhdimësia e shtetit të Kosovës ka qenë dhe do jetë e drejtë. Juristë eminentë e referencojnë atë pafundësisht në literaturën moderne kurse studentët e drejtësisë e mësojnë atë si një nga aktgjykimet më përmbajtësore që vendosi bazat e normave që rregullojnë lindjen e shtetit të ri në një kontekst post-gjenocidal e post-kolonial bashkëkohor. Tendencat e Serbisë për të minimizuar peshën e Mendimit Këshillëdhënës të GjND-së, përfshirë moszbatimin e

parimeve të Kartës së OKB-së në marrëdhëniet e saj me Kosovën që janë pjesë thelbësore e Marrëveshjes Bazike, do mbeten vepra të një shteti që tenton në keqbesim rehabilitimin e dështuar të saj në bashkësinë e kombeve të civilizuar pasi që ushtroi gjenocid në territorin e tre shteteve të sotshme dhe vazhdon në mënyrë institucionale ta mohojë atë", ka shkruar Kurti.

Edhe Partia Demokratike e Kosovës ka shkruar në "Facebook" se më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë konstatoi se shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare. "Ky vendim e vulosi përfundimisht të drejtën e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Shpallja e pavarësisë si suksesi më i madh historik i popullit dhe shtetit tonë, pasqyron vullnetin dhe

përpjekjen për shtetformim e shtetndërtim të një lidhshipi vizionar, në koordinim me aleatët ndërkombëtarë, me angazhim e përkushtim për ndërtimin e një të ardhmeje të sigurt për secilin qytetar", ka njoftuar PDK-ja.

Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) është një nga momentet më të rëndësishme në historinë tonë të shtetësisë dhe shtetndërtimit. "Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 u konfirmua nga GjND më 22 korrik 2010, e cila vulosi shtetësinë dhe të drejtën tonë të fituar me luftën çlirimtare, një hap ky i rëndësishëm drejt afirmimit të shtetit tonë sovran. Kosova duhet të vazhdojë të ndjekë vlerat perëndimore dhe të thellojë partneritetin e saj me miqtë dhe aleatët, veçanërisht

U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi midis Kuvendit dhe organizatës Balkan Green Foundation

Prishtinë, 22 korrik - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim drejtorin ekzekutiv të organizatës Balkan Green Foundation (BGF), Agron Demi, me të cilin nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi për mbështetjen e shërbimeve hulumtuese dhe analitike në Kuvend përmes Drejtorisë së Përgjithshme për Institutin Parlamentar. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një platforme

bashkëpunimi në hulumtime dhe analiza që ndihmojnë Kuvendin e Kosovës në formulimin e politikave dhe ligjeve që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Sipas marrëveshjes, BGF do të mbështesë Drejtorinë e Përgjithshme duke kryer hulumtime dhe analiza për politika të gjelbra dhe zhvillim të qëndrueshëm, për të mbështetur deputetët dhe organet e Kuvendit në procesin ligjbërës, mbikëqyrës dhe

përfaqësues, si dhe do të angazhohet në fushata edukuese dhe promovuese për të rritur ndërgjegjësimin për kujdesin ndaj mjedisit. Balkan Green Foundation gjithashtu do të ndajë informacione dhe njohuri të marra nga hulumtimet dhe fushatat e tyre me Drejtorinë e Përgjithshme dhe organet e Kuvendit, si dhe do të bashkëpunojë në ngritjen e kapaciteteve hulumtuese dhe analitike, në shkëmbim të

përvojave dhe në zhvillimin e platformave të diskutimit. Sipas marrëveshjes së nënshkruar, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht drejtoria e përgjithshme për Institutin Parlamentar ndan të dhëna dhe informacione relevante me BGF-në për të lehtësuar hulumtimet dhe analizat, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e Kuvendit, mundëson shpërndarjen e studimeve të BGF-së, si burime

të klasifikuara zyrtare në lidhje me fushën e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm si në edukim, ndërgjegjësim dhe praktika profesionale për institucione publike dhe private, siguron ndarjen në kohë dhe të saktë të të dhënave për nismat hulumtuese të ndërmarra nga BGF që ndërlidhen me Kuvendin, si dhe, ndër të tjera, ndan ekspertizë dhe burime njerëzore për të mbështetur zbatimin e nismave të përbashkëta.



me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si rrugë e vetme për të arritur qëllimet tona si shtet”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Për 14-vjetorin e konstatimit të GjND-së se “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk

paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare”, ka shkruar edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. “14 vjet nga konstatimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk paraqet shkelje të së drejtës

ndërkombëtare”. Më 22 korrik të vitit 2010, Kosova bashkoi njerëzit më profesional në bashkëveprim me miqtë strategjik, për të dëshmuar legjitimitetin e të drejtës sonë për liri, pavarësi dhe demokraci. Ky vendim i shumëpritur dhe

grykim i drejtë ishte vulë përfundimtare e drejtësisë, e cila i mundësoi Kosovës kërkimin e përfshirjes si shtet i barabartë mes atyre shteteve demokratike. Kosova, në gjithë këtë periudhë me sfida ishte krah aleancës së pa rezervë të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës si dhe miqve të tjerë ndërkombëtar. Lidhja Demokratike e Kosovës mbetet krenare në rolin e pazëvendësueshëm që luajti konkretisht në këtë proces, dhe në këtë rrugë të denjë të Kosovës”, ka thënë Abdixhiku.

Komuna e Gjilanit u kërkon tatimpaguesve të pronës të paguajnë borxhet

GJILAN, 22 KORRIK - Komuna e Gjilanit u ka kërkuar tatimpaguesve të pronës të paguajnë borxhet, me mundësi për programim të borxhit deri në 24 këste. Komuna e Gjilanit kërkon nga të gjithë tatimpaguesit e pronës, të cilët kanë borxhe nga vitet paraprake, të kryejnë

pagesat në tërësi. “Nëse debitori nuk paguan detyrimet tatimore të papaguara në datën e përcaktuar për pagesë, Komuna e Gjilanit, është e detyruar të veprojë sipas Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe udhëzimit administrativ. Për t’ia lehtësuar qytetarëve

pagesën e borxhit, ju mundësohet nënshkrimi i marrëveshjes për pagesë prej 12 deri në 24 këste mujore. Për këtë, duhet të lajmërohen qytetarët te zyrtarët e Tatimit në Pronë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Gjilanit”, ka njoftuar Komuna e Gjilanit.



Drenas, 101 fermerë përfitojnë makina për spërkatjen e barishteve dhe makina për shpërndarjen e plehut artificial

DRENAS, 22 KORRIK - Komuna e Drenasit ka mbështetur 101 fermerë me makina për spërkatjen e barishteve dhe makina për shpërndarjen e plehut artificial.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci ka thënë se subvencionet për bujqësi, kurrë nuk janë të mjaftueshme për bujqit e zellshëm, por brenda mundësive buxhetore, po e bëjnë

më të mirën e mundshme për ta. “Për këto spërkatëse, kishte 133 aplikantë, por, Komisioni sipas dokumentacionit dhe kushteve për subvencionim, ka përzgjedhur 70 përfitues. Ndërsa

për shpërndarëse të plehut artificial kishte 38 aplikantë, prej tyre përfituan 31 bujq sipas vlerësimit të komisionit komunal për subvencionet në bujqësi. Falënderojmë Islamic Relief USA

për përkrahjen e bujqve tanë të cilët nëpërmjet këtyre pajisjeve sigurojnë qëndrueshmërinë dhe kushtet më cilësore të prodhimit bujqësor”, ka shkruar Lladrovci në “Facebook”.



Për një javë zyrtarët policorë të rajonit të Prishtinës realizuan 253 urdhëresa të gjykatës



PRISHTINË, 22 KORRIK - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës, gjatë javës që lamë pas në lokacione të ndryshme e aksione të ndara, janë realizuar 253 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 47 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Në përputhje me urdhëresat, pas përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me

burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë, janë liruar, pasi të njëjtët kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa. Ndërkohë që aktivitetet policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. “Kësisoj në harkun e njëjtë kohor janë sekuestruar 8 armë, prej tyre 4 armë zjarri, të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, si dhe

dhjetëra municione të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor kanë qenë më të theksuara. Në po të njëjtën periudhë kohore, nga aktivitetet të tilla ka rezultuar shqiptimi 4311 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Për herë të parë mbahet gara e peshkimit në Kamenicë

KAMENICË, 22 KORRIK - Liqeni i Rubocit mori një pamje më ndryshe të dielën e 21 gushtit. Kjo për shkak se këtë ditë u mbajt gara e peshkimit në kuadër të Festivalit “Kamenica Summer Fest”. Në këtë garë të organizuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me SHPRS-

në “Mlyshi” në krye me Fisnik Kastratin, morën pjesë garues të cilët i shoqëronte qetësia dhe vëmendja e tyre ishte fokusuar tërësisht në atë që bënin. Gara u mbajt në dy kategori, atë senior dhe junior, ku pas përfundimit për fituesit u ndanë kupa, mirënjohje dhe shpërblime

në mjete financiare. Po ashtu garën e peshkimit e përcollën nga afër drejtori i DKRS-së, Behar Hyseni dhe drejtori i Investimeve Kapitale, Blerim Murina, kurse nga Federata e Peshkatarëve Sportiv të Republikës së Kosovës, garën e përcollën kryetari Milaim Vitia dhe sekretari Sedat Gjinolli.



Një delegacion i mjekëve nga Turqia do të realizojë 50 operacione të fëmijëve në Kosovë me probleme në buzë dhe hundë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Një delegacion i mjekëve dhe stafit tjetër përcjellës nga Turqia, do të realizojë 50 operacione të fëmijëve në fushën e Kirurgjisë Plastike dhe Kirurgjisë Maksilofaciale që kanë lindur me probleme në buzë dhe hundë, mision ky që po realizohet në kuadër të Shoqatës "Interplast" nga Turqia.

Me këtë rast, për t'i dëshiruar mirëseardhje delegacionit nga Turqia, prezentë ishte ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ministri i Zhvillimit Rural, Fikret Damko, Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili dhe përfaqësues të organizatës TIK-a, që po ashtu, përkrahen projektin.

Në emër të SHSKUK-së, mirëseardhje delegacionit nga Turqia i uroi dr. Ardian Shefkriu, i cili i falënderoj ata për gatishmërinë, kontributin dhe bashkëpunimin që do të japin në QKUK, e cila do të shërbejë edhe si eksperiencë për stafin tanë.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka falënderuar shtetin turk

për investimet e deritanishme dhe bashkëpunimin e ofruar. "Ne si shtetet kemi kaluar fazën emergjente me donacione dhe investime, populli mik na ka ndihmuar, kemi nevojë për ekspertizën e jashtëzakonshme nga shteti mik, prandaj, prania e profesorit dhe profesionistëve nga Turqia do të ndihmojë 50 pacientë. Ajo që më gëzon është se do kemi mundësi edhe të edukojmë stafin dhe të zhvillohemi profesionalisht. Ky ishte hapi i parë i një bashkëpunimi që do të vazhdojmë me Kirurgji Maksilofaciale dhe Kirurgji Plastike", ka theksuar ministri Vitia.

Ambasadori turk në Kosovë, Sabri Tunç Angili, mes tjerash potencoi se Kosova ka nevojë për përvojën e mjekëve nga Turqia të cilët kanë numër më të madh të pacientëve dhe më shumë eksperiencë. "Kosovën e shohim si vend mik dhe vëlla, ne mendojmë se është e natyrshme vëllazëria dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Dua të falënderoj TIK-a, për realizimin e këtij projekti, por edhe ministrin Fikret Damka, që ka realizuar ndihmuar këtë projekt", përfundoi ambasadori



Sabri Tunç Angili.

Ministri i Zhvillimit Rural, Fikret Damka, i cili vjen nga komuniteti turk, e që ka ndihmuar në realizimin e këtij projekti, tha se lidhjen ndërmjet Kosovës dhe Turqisë dhe përkrahjen po mundohen të forcojnë edhe në fushën e shëndetësisë. "Ne e kemi dizajnuar me kohë këtë ide, i falënderojmë që na ndihmuar

po mundohemi që lidhjen e urës ta forcojmë dhe të bëjmë këtë edhe në shëndetësi, ku ndarja e përvojës është me rëndësi", ka thënë Damka.

Profesori nga Turqia, Metin Yavuz, kirurg plastik dhe rekonstruktiv, ka thënë se kanë kemi vlerësuar pacientët tek të cilët do kryejnë intervenime dhe kanë marrë vendimet. "Do të kryejmë operacione tek të

porsalindurit me probleme në buzë dhe hundë, këto raste nëse nuk kryhen deri 18 muaj shfaqen probleme që nuk mund të kryhen më vonë. Kemi planifikuar të kryejmë 20 operacione, por pas vizitave dhe kontrolleve do të kryejmë deri në 50 intervenime, përfshirë ato me anestezion lokal dhe të përgjithshëm", u shpreh ai.

Këshilli i BE-së merr vendim për t'ua hequr vizat serbëve të Kosovës

PRISHTINË, 22 KORRIK - Këshilli i Bashkimit Evropian mori vendim për t'ua hequr regjimin e vizave qytetarëve të Kosovës që posedojnë pasaporta serbe, të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë.

Vendimi u mor në nivel të ministrave të Jashtëm në mbledhjen e fundit të këtij semestri.

Me të përfundojnë të gjitha proceset legjislative.

Pasi të hyjë në fuqi, gjë që pritet të ndodhë në ditën e 20-të pas botimit në Gazetën Zyrtare të BE-së, vendimi do të fillojë të zbatohet në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. "Sot, Këshilli i BE-së miratoi një rregullore që siguron se i gjithë rajoni i



Ballkanit Perëndimor i nënshtrohet të njëjtit regjim vizash, duke anuluar përjashtimin që aplikohej më herët për mbajtësit e pasaportave serbe, të lëshuara

nga Drejtoria e Koordinimit e Serbisë", thuhet në deklaratën e BE-së. Procedurat për anulimin e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës me pasaporta serbe

nisën në vazhden e liberalizimit të vizave për Kosovën, nga 1 janari i këtij viti.

Me heqjen e vizave për qytetarët me pasaporta të Kosovës, qytetarët që posedojnë vetëm dokumente të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë - e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Brendshme serbe në Beograd - mbetën të vetmit në rajon që u duheshin viza për të udhëtuar në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen.

Komisioni Evropian propozoi heqjen e vizave për ta në nëntor të vitit të kaluar.

Parlamenti Evropian votoi për këtë çështje në prill të këtij viti. Këto vendime nxitën reagime nga Qeveria e Kosovës.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi tha në nëntor të vitit 2023 se "njohja e këtyre dokumenteve e minon integrimin e komunitetit serb" dhe "i dëmton përpjekjet tona të kahershme [për integrimin e serbëve]".

Kosova nuk i njej pasaportat në fjalë dhe mbajtësit e tyre nuk mund të fluturojnë me to nga Aeroporti i Prishtinës.

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriq, e përshëndeti vendimin e fundit të Këshillit të BE-së. "Një fitore e vogël, por e rëndësishme për të drejtat e njeriut të serbëve në 'Kosovë dhe Metohi'", ka shkruar Gjuriq në platformën "X".

Fluksi në pikat kufitare, gjysmë ore pritje në Merdar dhe kolona të gjata te Dheu i Bardhë

Prishtinë, 22 korrik - Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar, ka publikuar të dhënat e fundit sa i përket fluksit të automjeteve në pikëkalimet kufitare.

Sipas raportit të orës 07:06 në pikat e kalimit kufitar në Merdar dhe te Dheu i Bardhë raportohet për pritje të gjata. Në pikën kufitare të Merdarës, koha e pritjes për automjetet në hyrje është

rreth 30 minuta, ndërsa në dalje është 10-15 minuta, ndërsaq nuk dihet sa është kolona e gjatë.

Në pikën kufitare të Dheu i Bardhë, koha e pritjes në hyrje është 20 minuta dhe në dalje 10 minuta.

Edhe pse këto kohë pritjeje janë më të shkurtra krahasuar me Merdarën, prapë ka pasur formim të kolonave, deri në 100 metra

në hyrje dhe 50 metra në dalje.

Në pikat tjera kufitare nuk raportohet për pritje të gjata e as kolona të automjeteve.

Në përgjithësi, udhëtarët që planifikojnë të kalojnë nëpër këto pika kufitare duhet të jenë të përgatitur për pritje më të gjata se zakonisht dhe të marrin masa për të minimizuar vonesat e mundshme.



Turizmi në Shqipëri: Mangësi nga brenda apo sulme nga jashtë

TIRANË, 22 KORRIK - Bumi turistik që përjetoi Shqipëria një vit më parë, e rriti pritshmërinë që këtë sezon të ketë edhe më shumë turistë.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Qeveria shqiptare, nga janari i këtij viti deri në qershor, këtë vend e vizituan 4.5 milionë turistë, ose 34 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Por, ajo që tërhoqi vëmendjen kohëve të fundit, ishte publikimi i disa fotografive dhe videove në rrjetet sociale, që, sipas atyre që i shpërndanë, ishin të plazheve shqiptare me shumë pak njerëz ose të boshatisura.

Për kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, publikimi i këtyre imazheve është "një sulm i organizuar" për të dëmtuar turizmin shqiptar.

Por, ekspertët e turizmit nuk e shohin ashtu situatën. Sipas tyre, ka disa mangësi që lidhen me shërbimin dhe infrastrukturën, si dhe me rritjen e çmimeve.

Sulm apo dështim?

Në një adresim më 17 korrik, Rama shprehu bindjen se bëhet fjalë për një sulm të organizuar, me qëllim të dëmtimit të turizmit shqiptar. "Kam folur me krerët e bashkive bregdetare që janë të habitur nga shumë video, lajme e komente të rreme, të manipuluar, të bëra me qëllim e që duan të thonë se këtu s'ka ardhur njeri. Sulmi vjen nga disa anë", tha Rama, pa specifikuar më shumë. "Sistemet tona të sigurisë kanë ndezur dritën e kuqe, të sigurisë kibernetike. Ka shumë profile false që përdoren për këtë sulm", shtoi ai.

Për ekspertin e turizmit në Shqipëri, Leonard Maçi, kjo deklaratë e Ramës është përpjekje për të justifikuar dështimin për të tërhequr turistë. "Unë do të bëja një krahasim: nëse një njeri ka probleme me një nga organet e trupit, atëherë preken edhe organet e tjera. Pra, kjo vjen nga



brenda dhe jo nga jashtë. Ajo që dua të them, është se nuk ka asnjë sulm apo sabotim të huaj", thotë Maçi për Radion Evropa e Lirë. "Këto janë teori konspirative për të justifikuar veten, mungesën e kontrolleve sa i takon rritjes abuzive të çmimeve apo mosmarrjes së masave për të përmirësuar shërbimin dhe infrastrukturën", shton ai.

Sipas tij, një nga arsyt përse turistët zgjedhin Shqipërinë vitin e kaluar, ishin dhe çmimet e lira, që këtë vit janë rritur. "Çmimet, sidomos në jug, janë rritur në mënyrë joproporcionale dhe të pashembullt. Dhe, pritshmëria ndaj çmimeve të ulëta ka rënë bashkë me reklamën që i është bërë këtij fenomeni. Pra, kemi efektin bumerang. Duhet masa paraprake para se të bësh turizëm, duhet të kesh siguruar njëherë asete dhe produkte, e më pas t'i shesësh", thotë Maçi.

Problemin me rritjen e çmimeve, kryesisht në jug të Shqipërisë, e pranoi edhe Rama, pak ditë më parë.

Duke iu drejtuar kryebashkiakëve të Vlorës dhe Sarandës, ku raportohen çmime të larta

krahasuar me një vit më parë, Rama kërkoi nga ta që të bisedojnë me operatorët turistikë për këtë problematikë. "Duhet t'u thuhet se kjo është jo vetëm e padrejtë, por është strategjikisht vetëvrasje për vetë ata", tha Rama në takimin me kryebashkiakët. Maçi, në anën tjetër, shton se është e patolerueshme që pikërisht në kulmin e sezonit turistik në Shqipëri, kryhen punime në infrastrukturë, të cilat, siç thotë, shkaktojnë trafik dhe ndotje.

Kjo problematikë, sipas tij, është një tjetër arsye që sivjet numri i turistëve do të jetë më i ulët. Asaj i shton edhe, siç thotë, mungesën e pjesëmarrjes së Shqipërisë me atë që ofron, në panairët ndërkombëtare.

Rezerva për shifrat e turistëve

Besnik Vathi, një operator turistik në Shqipëri, thotë se ka rezerva në lidhje me shifrat që i deklarojnë institucionet shqiptare për numrin e turistëve. "Ne i raportojmë hyrjet në kufi, e që nuk janë të gjithë turistë", thotë ai. "Në

mesin e tyre janë edhe turistë, edhe ata që quhen vizitorë të së njëjtës ditë... E, për shkak të rëndësisë që po merr Aeroporti i Rinasit për rajonin, janë me qindra mijëra udhëtarë nga Kosova, Mali i Zi apo Maqedonia e Veriut që e përdorin atë, për të kapur fluturime direkte, pasi krahasuar me vendet e tyre, janë 3-4 herë më lirë", thotë Vathi.

Sipas tij, duhet parë nëse ata që hyjnë nga një kufi tokësor, dalin brenda orësh apo qëndrojnë. "Nëse nuk raportojmë në këtë mënyrë, vihet në dyshim saktësia sa u përket shifrave të turizmit", thotë Vathi. "Nëse u referohemi hyrjeve nga Kosova", thotë ai, asnjëherë nuk është saktësuar se sa prej tyre janë pushues në Shqipëri, e sa e shfrytëzojnë territorin e Shqipërisë për të kaluar në Mal të Zi. "Mund të jenë edhe qytetarë me pasaporta zvicerane apo gjermane, që mund të futen në Shqipëri nga kufiri me Malin e Zi, të kalojnë dhe të shkojnë në Kosovë, ose anasjelltas. Dhe ne, me këtë mënyrë matjeje, i llogarisim si turistë të huaj, e në fakt duhen klasifikuar si vizitorë transit", thotë Vathi.

Më pak a më shumë kosovarë?

Kryeministri shqiptar, në takimin me kryebashkiakët, tha po ashtu se pretendimi i disa ekspertëve të turizmit se shtetasit e Kosovës e kanë "braktisur" Shqipërinë, është i pabazë. "Nga janari në qershor janë 1.7 milion hyrje të qytetarëve të Kosovës ose 25 për qind më shumë se vjet", tha Rama.

Por, edhe për këtë çështje, ekspertët ndajnë një mendim tjetër. "Institucionet shtetërore thonë se në gjatë muajt e parë të këtij viti kanë ardhur 1.7 milion turistë, ndërkohë që popullsia e Kosovës është 1.6 milion banorë. Nuk mund t'i llogarisësh si turistë, sepse duhen ndarë udhëtarë, turistë, vizitorë...", thotë Maçi.

Vathi, në anën tjetër, pret të ketë rritje të numrit të kosovarëve që do të hyjnë në Shqipëri, por turistët, sipas tij, do të mbeten në nivelet e një viti më parë ose më pak. "Numri i kosovarëve, nëse do t'i qëndrojmë kësaj metodologjie, do të ketë rritje, për shkak se liberalizmi i vizave [për Kosovën] dhe çmimet e ulëta që ofron Aeroporti i Rinasit përmes linjave 'low cost', u japin atyre mundësi të kalojnë përmes territorit tonë, për të shkuar në destinacionet që zgjedhin", thotë Vathi. "Pra, do të kemi më shumë udhëtarë kosovarë, por nuk mund ta them të njëjtën gjë për numrin e turistëve kosovarë", thekson ai.

Gjatë vitit 2023, Shqipëria regjistroi një numër rekord turistësh - prej 10.1 milionësh. Për një raportim të Radios Evropa e Lirë më 23 qershor, Mehdi Olluri nga Lipjani i Kosovës, që kishte zgjedhur Shëngjinin e Shqipërisë për të pushuar, tha se krahasuar me një vit më parë, çmimet janë më të larta. "Ka rritje të [çmimeve të] ushqimeve në dyqane, në restorante, e gjithashtu edhe banesa është më e shtrenjtë se vjet", tha ai.

ATK-ja në aksion, bizneset kontrollohen për kuponë fiskalë dhe regjistrim të punëtorëve

PRISHTINË, 22 KORRIK - Administrata Tatimore e Kosovës ka krijuar një grup operativ për muajt e verës për të luftuar evazionin fiskal.

Grupi operativ apo "Task Forca", është krijuar me vendim të drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, me qëllim të luftimit të evazionit fiskal të bizneset që llogariten të kenë qarkullim të madh.

Gjatë vikendit të kaluar cak i inspektimeve ishin pishinat dhe bizneset që operojnë brenda tyre. Inspektori Ndriçim Çerkini, tregon se pse pikërisht janë zgjedhur pishinat. "Pas suksesit që kemi pasur vitin e kaluar si grup operativ, me vendim të drejtorit edhe këtë vit është krijuar 'Task

Forca', e cila do të vazhdojë gjatë gjithë muajve të verës. Këtë vikend i kemi inspektuar pishinat sepse edhe koha ishte me diell dhe ditë vikendi, i kemi kontrolluar për kuponë fiskal dhe për regjistrimin e punëtorëve", thotë Çerkini.

Në hyrje të pishinës së parë inspektorët kërkojnë raportin 'X' të arkës fiskale dhe fillojnë kontrollimin e tavolinave se a janë të pajisura me kuponë fiskalë. Pasi kanë evidentuar se të gjitha tavolinat nuk kanë kupon fiskal inspektorët fillojnë t'i pyesin edhe klientët se a u është afruar kuponi fiskal.

Menaxherit i bëhet me dije se disa tavolina dhe çadra të pishinës nuk kanë kupon fiskal, dhe se

obligohet t'i shërbej me kupon të gjithë mysafirët në prezencën e inspektorëve. Pasi ka përfunduar shpërndarja e kuponëve fiskalë përsëri kërkohet nxjerrja e raportit nga arka fiskale e cila më pas e dëshmon se sa kuponë janë shmanjur dhe nuk u janë ofruar klientëve në momentin e porosisë. Të dhënat nga raporti i hartuar brenda kësaj pishine do të përcillen te zyra e ATK-së e cila merret me shqiptimin e gjobave. Inspektimet do të vazhdojnë te ato kafiteri në Prishtinë, që sipas raporteve inteligjente të ATK-së janë ndër më të frekuentuarat gjatë kësaj kohe dhe nuk lëshojnë rregullisht kuponë fiskalë.



Emërtimi 'Kosovë/Kosova' në shekujt osmanë



Nga: Agron ISLAMI

Ndryshe prej shteteve mesjetare bullgare e serbe, administrata osmane nuk e bëri ndërrimin e emër- vendeve (me ndonjë përjashtim), por i njohu ato ashtu siç përdorshin në sundimet e mëparshme. Kështu, edhe emri Kosovë, i cili në aspektin gjuhësor nënkupton “fushën e mëllenjave”, u adoptua nga gjuha e vjetër greko-bizantine, respektivisht nga emri *Kusovon dhe Kosofus*. Me të njëjtin kuptim e gjejmë edhe te burimet me shkrim latin, të cilat kur bëjnë fjalë për vendin ku u zhvillua Beteja e Parë e Kosovës (1389), përmendin emërtimet *Rigo Mezeo, Amsfeld, Campus Merulus etj.*, që të gjitha në kuptimin e zogut të zi (mëllenjës së zezë) e njohur edhe si *turdus merula*.

Emrin *Kosovë* në burimet osmane e gjejmë të shkruar në kronikat e shek. XV, të cilat bëjnë fjalë mbi përballjen e osmanëve me aleancën e

popujve të Ballkanit të sotëm në Betejën e vitit 1389. Kjo Betejë konsiderohet si njëra nga sfidat e rralla të osmanëve për të shtrirë sundimin e tyre në hapësirat e tokave që më herët kishin qenë nën sundimin e gjatë Romako-Bizantin. Njëherësh, rënia e Sulltan Muratit të Parë në Fushën e Mëllenjave / Kosovë, sikur vulosi edhe emërtimin e ri të kësaj hapësire të Dardanisë Antike, e cila u pllakos në memorien e osmanëve dhe u bë sinonim me vendvarrimin e Sulltanit. Kështu, nga kjo kohë, në literaturën osmane, krahas emrit *Kosovë* përdoret edhe epitete *me hed-i Hüdâvendigâr* – vendvarrim i Shehidit / Dëshmorit më të madh osman. Ky sinonim i Kosovës u rrënjësua edhe më shumë me ngritjen e tyrbes / mauzoleumit, kushtuar Sulltan Muratit të Parë, në Obiliq të sotëm të Komunës së Fushë Kosovës.

Emri *Kosovë*, i cili identifikohet me vendvarrimin e organeve të brendshme të Sulltan Muratit

të Parë dhe me vendin e fushëbetejës, e cila nga folësit greko-bizantin njihet si *Kusovon* dhe *Kosofus*, në kronikat osmane të shek. XV u shkrua në dy forma të ndryshme. Respektivisht, një pjesë e kronikantëve të shek. XV atë e regjistruan si duke përdorur germën osmane “Kef”, e cila lexohet si *Kösova*, ndërsa pjesa tjetër e cila përbën shumicën, kanë përdorur germën Kaf që shqiptohet si *K* e fortë dhe jep emrin *Kosova*. Versionin e fundit e gjejmë në kronikën *Tevarih-i Al-i Osman* (Historia e Shtetit të Lartë Osman) të Ashikpashazadesë, *Kitab-i Cihannüma* të Neshriut dhe *Tacü't-tevarih* të hoxha Sadedinit”, ashtu sikurse edhe në dokumentet zyrtare osmane.

Ndryshe prej kronistëve të shek. XV, kronikantët e mëvonshëm të shek. XVII dhe XVIII, Kosovën e paraqesin si njësi administrative në kuadër të Sanxhakut të Vushtrrisë. Është Katip Çelebiu, njëri ndër gjeografët më të njohur osman të shek. XVII, i cili në veprën e

tij të titulluar *Cihannüma*, shkruan për “Vilajetin e Kosovës” (sipas tij) i cili “gjendet 19 ditë larg nga Stambolli”. Po sipas këtij autori, Vilajeti i Kosovës gjendej mes Prishtinës, Kurshunllusë (Kurshumlisë) dhe Trepçës. Në të njëjtën vepër, shkruhet se brenda Vilajetit të Kosovës gjenden sanxhaqet e Prishtinës, Allaxhahisarit (Krushevcit – A.I.), Janovës (Janjevës -A.I) dhe Vilçiterinës. Pra, sipas këtyre kronikantëve, kemi të bëjmë me një njësi të veçantë të administratës osmane, por që kjo nuk dëshmohej në dokumentacionin zyrtar të kohës. Përkundrazi, deri në themelimin e vilajetit të Kosovës (1877/8), dokumentet e administratës osmane bëjnë fjalë vetëm për emërtim gjeografik dhe jo administrativ. Kjo bëhet e qartë në aktet e fillimishek. XVIII, ku kazaja e Prishtinës, Vilçiterinës, Moravës së Binçes (Binçe-i Morava), Novobërdës dhe Janovës së Moçme (Yanova-i Kadim), identifikohen si rajon

gjeografik me emrin Kosovë (pra bëhet fjalë për rrafshin e Kosovës së sotme). Po kështu, në aktin e datës 18-26 gusht 1737, urdhërohet Hysejni, i biri i Mustafa Pashës me gradën *mirliva*, që të sulmojë mbi ushtritë austro-hungareze të cilat kanë aneksuar Nishin dhe shumë shpejt pritet që të zbresin në trevën e quajtur Kosova”.

Siç dihet, një pjesë e studiuesve shqiptarë (sikur profesori Skënder Riza) mbrojnë opinionin se treva e Kosovës ka qenë homogjene dhe origjinën e ka nga gjuha që flisnin ilirët dhe trakët. Sipas këtij opinionin, emri *Kosovë* haset edhe në treva të tjera të banuara në antikitet nga ilirët dhe trakët. Psh. në Bosnjë ekziston emërtimi *Fushë e Kosovës*; në Dibër, fshati *Kosova*; në Dalmacinë Juglindore, në fushën e Kninit, emri i fushës *Kosova* ku rrjedh lumi *Kosovica*. Po ashtu, sipas këtij opinionin edhe në Shqipëri, në qytetet e Elbasanit dhe të Gjirokastrës kemi fshatra me emrin *Kosovë*. /Telegraf/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Përfundon Evropiani në Prishtinë, Sllovakia shpallet kampione

Prishtinë, 22 korrik - Ka përfunduar të dielën Kampionati Evropian U20 për hendbollistë i mbajtur për nëntë ditë në Prishtinë. Kampione u shpall Sllovakia, që në finale fitoi ndaj Letonisë me rezultat 31:25. Sllovakët kanë dominuar gjatë gjithë ndeshjes dhe kanë festuar në fund. Medaljen e bronzitë e fitoi Finlanda. Të mbyllur Evropianin për hendbollistët deri në 20 vjet e shpallën

presidenti i EHF-së, Eugen Saraçini dhe anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të EHF-së, Pedro Sequeira. Presidenti Saraçini ka falënderuar delegacionet, stafin lokal dhe sponsorët e FHK-së që kanë ndihmuar në këtë organizim madhështor. "Shihemi në organizimet tjera", u është drejtuar Saraçini të pranishmëve. Ndërkohë Sequeira e ka vlerësuar Evropianin në kryeqendrën

tonë si të mahnitshëm. Ai ka thënë se kjo ngjarje është e rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen e hendbollit. Presidenti Saraçini dhe Sequeira kanë ndarë trofeun e kampionit për kapitenin e Sllovakisë. Të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë përfaqësuesit e EHF-së dhe të delegacioneve e kanë vlerësuar shumë lartë organizimin e Evropianit dhe ndeshjet e zhvilluara gjatë tij.



Liga e Konferencës: Ballkani, Drita dhe Llapi mësojnë kundërshtarët për rrethin e tretë

"Epoka e re"


PRISHTINË, 22 KORRIK - Ballkani, Drita dhe Llapi po e përfaqësojnë Kosovën në garat evropiane, përkatësisht në Ligën e Konferencës. Kampionët e Kosovës, Ballkani pasi u eliminuan nga Liga e Kampionëve tash do të përballen në rrethin e dytë me Hamrunin në Ligën e Konferencës dhe nëse e kalon këtë skuadër, atëherë në rrethin e tretë do të përballen me Lamën. Ballkani erdhi këtu pasi u eliminua nga Liga e Kampionëve, Llapi u eliminua nga Liga e Evropës, derisa Drita erdhi në fazën e dytë

direkt. E sot, të tri klubet kosovare kanë mësuar kundërshtarët e mundshëm për rrethin e tretë, nëse e kalojnë atë të dytin. Në anën tjetër, Drita e cila kaloi direkt në fazën e dytë do të ketë punë me Bredaiblik. Nëse gjilanasit e mposhtin këtë kundërshtar, në rrethin e tretë përballen me fituesin e ndeshjes FK Auda - Cliftonville. Skuadra e tretë kosovare që bën gara në Ligën e Konferencës, Llapi pasi është eliminuar nga Liga e Evropës në rrethin e dytë përballen me gjigantin danez Brøndby dhe në rast të fitores atëherë do të kenë punë aspak të lehtë për faktin se shoti i ka venë përballë fituesit nga ndeshja Legia

Varshavë - Caernafon Town.

Sot tërhiqet shorti për edicionin e ri në Superligë

Komisioni i Garave i Superligës ka njoftuar klubet dhe opinionin se shorti për edicionin e ri garues 2024/25 në AlbiMall Superligën e Kosovës në futboll do të tërhiqet të martën, më 23 korrik. Ceremonia e tërheqjes së shortit do të zhvillohet në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës në orën 13:00 dhe do të bëhet në praninë e përfaqësuesve të klubeve dhe mediave.



Ramadani: Tifozët e Lecces ishin me mua në 'Euro 2024'



LECCË, 22 KORRIK - Ylber Ramadani, i kthyer nga pushimet pas Kampionatit Evropian të luajtur me Shqipërinë, ka dhënë një intervistë të shkurtër për mikrofonat e U.S. Lecce në të cilën në Gjermani me kuqezinjët, objektivat e së ardhmes për sezonin e ri nën urdhrat e trajnerit Luca Gotti dhe në fund për bashkëlojtarin e tij, si në klub ashtu edhe në kombëtare, Medon Berisha. "Kam bërë mirë në Kampionatin Evropian dhe jam

rikthyer këtu, tani po filloj një punë tjetër duke shpresuar të kem një sezon të mrekullueshëm. Të gjithë tifozët e Lecce më shkruanin se ishin me mua në 'Euro 2024' dhe ishte një gjë e bukur për mua, një mbështetje që nuk mungoi as në Shqipëri. Me kombëtaren patëm një kampionat të madh evropian, por mund të kishim bërë akoma më shumë", ka thënë Ramadani. "Synimet e mia janë të arrijmë sa më lart, shpëtimi po, por synimi është gjithmonë të fitojmë sa më

shumë ndeshje. Kam përgjegjësi të mëdha dhe e njoh mirë mentalitetin e të gjithë atyre që do të marrin pjesë në këtë sezon", ka shtuar ai. "Asgjë nuk mund t'u thuhet tifozëve tanë, ata japin gjithçka në shtëpi dhe me ta mund të bëjmë histori në Serinë A. Berisha? Ai ka luajtur shumë mirë në tre ndeshjet e fundit dhe është vënë në nga trajneri. Duke qenë një lojtar i ri me cilësi të madhe, shpresoj se mund të ketë gjithashtu një sezon të shkëlqyer", ka deklaruar Ramadani.

Biznesmenët e Drenasit mbështesin fuqishëm FC Feronikeli 74

Drenas, 22 korrik - FC Feronikeli 74 po përjeton një fazë të re dhe emocionuese falë bashkëpunimit me bizneset më të mëdha dhe të njohura të Komunës së Drenasit. Në stadiumin "Rexhep Rexhepi" është ndjerë një frymë e re, ku personalitetet më të suksesshme të biznesit janë

bashkuar për të mbështetur dhe drejtuar klubin e zezmërës së tyre. "Kampionët e biznesit, Sokol Gashani, Ekrem Elshani, Mehdi Gjoka, Qazim Asllani, Petrit Leku, Bedri Gllareva, Erlind Krasniqi, Burim Bujupi, Musa Binaku, dhe të tjerë, kanë vendosur t'i japin FC Feronikeli 74 mbështetjen e tyre të plotë.

Këta liderë të suksesshëm, të njohur jo vetëm në Drenas por edhe në të gjithë Kosovën, tani janë flamurtarët e suksesit të klubit tonë. KY bashkëpunim i ri pritet të sjellë një energji të freskët dhe një rikthim të frymës fitimtare në klub", thuhet në njoftimin e Feronikelit. FC Feronikeli 74

synon të rikthehet në majat e suksesit, duke përmbushur dëshirat e zjarra të lojtarëve, stafit të klubit dhe tifozëve besnikë. "Ne i gëzohemi kësaj faze të re dhe jemi të sigurt se me këtë mbështetje të fortë, FC Feronikeli 74 do të rikthehet në vendin që e meriton. Le të festojmë së bashku frymën e



kampionit dhe sukseseve të ardhshme!", thuhet ndër të tjera në njoftimin e klubit nga Drenasi.

Riffa nga Bahrejn fiton garën në FIBA 3x3 Prishtina Challenger

PRISHTINË, 22 KORRIK - Pas dy ditësh spektakli, ka përfunduar gara ndërkombëtare FIBA 3x3 Prishtina Challenger. Në këtë event morën pjesën 16 skuadra nga mbarë bota, në mesin e tyre edhe skuadra vendase, Prishtina. Të

shtunën u zhvilluan ndeshjet në grupe, derisa e diela ishte e rezervuar për ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finalja. Po ashtu u zhvilluan garat për tri pikë, ngulitje, si dhe kishte lojëra shpërblyese e muzikë për të pranishmit në Sheshin "Zahir Pajaziti" në

Prishtinë. Kjo garë, ashtu si edhe FIBA 3x3 Women's Series u mbështet fuqishëm nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Finalja u zhvillua mes Riffa-s nga Bahrejni dhe Podgoricës nga Mali i Zi. Në fund skuadra nga Bahrejni fitoi 21:13 dhe fitoi me meritë

këtë garë, derisa në gjysmëfinale kishte eliminuar favoritin Vjenën. MVP u shpall Dennis Donkor, çmim të cilin ia ndau Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu. Ndërkohë, çmimin kryesor e nda kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



Nadali, gati për Lojërat Olimprike

MADRID, 22 KORRIK - Rafael Nadal mund të mos jetë shumë i kënaqur me nivelin e performancës së tij në finalen e tij të parë që nga fitimi i titullit të Open France 2022, por spanjoli i lënduar ka thënë se ishte e rëndësishme të shmangej ndonjë lëndim në Bastad përpara Olimpiadës së Parisit. Spanjoli, i cili humbi pothuajse të gjithë vitin 2023 për shkak të një problemi në ijë dhe është kufizuar në gjashtë ndeshje këtë vit për shkak të një këputjeje muskulore dhe problemesh me palestrën, humbi 6-3, 6-2 në finalen e Suedisë Open nga portugez i shtatë, Nuno Borges. Pasi mposhti pasardhësin e pestë Cameron Norrie të enjten, Nadal fitoi ndeshje të vështira me tre sete kundër Mariano Navone dhe Duje Ajdukovic në dy raundet e tij të ardhshme dhe u duk se ndjeu efektet në finale. "Niveli ishte shumë larg nga ai që duhet të ishte. Ndoshta edhe energjia. Ka qenë një javë e gjatë me ndeshje të gjata",



ka thënë Nadal. "Nëse trupi im nuk kam dëmtime, kjo është e rëndësishme, por mendërisht dhe fizikisht, nuk jam mësuar të luaj katër ditë rresht dhe të luaj ndeshje të gjata", ka shtuar Nadal, i cili zgjodhi të anashkalojë Wimbledonin këtë muaj për t'u përgatitur për Olimpiadën në terrenet e Roland Garros, ku ai ka fituar 14 nga 22 titujt e tij Grand

Slam në single. Ish-numri një i botës, i cili pret të pensionohet në fund të këtij viti, fitoi një medalje të artë olimprike në 2008 dhe të artën në dyshe në 2016. Ai do të bashkohet me kampionin e French Open dhe Wimbledon, Carlos Alcaraz në garën e çifteve në Paris, ku turneu olimprik i tenisit zhvillohet nga 27 korriku deri më 4 gusht.

SHKURT

Zyba në formacionin e javës në Çeki

Qëndrim Zyba ka lënë gjurmë qysh në ndeshjen e tij debutuese me Slovan Liberec në Superligën e Çekisë. Mesfushori kosovar iu bashkua dy javë më parë Liberecit, derisa është inkuadruar në minutat e fundit ndaj Karvinas. Inkuadrimi i therrandasi ishte i qëlluar nga trajneri Radoslav Kovac, pasi Zyba asistoi te goli i tretë në fitoren 1-3 të Slovan Liberec. Paraqitja e reprezentuesit të Kosovës është vlerësuar dhe ai ka zënë vend në formacionin e javës në Superligën e Republikës së Çekisë. Sofa Score e ka vlerësuar atë me notë 7,8 dhe Zyba është futur në formacionin më të mirë të xhiros së parë.

Flick: Na duhen futbollistë që mund t'i fitojnë ndeshjet

Trajneri Hansi Flick vazhdon përgatitjet intensive të Barcelonës, me lojtarët që po marrin ngarkesën e duhur për sezonin e ri. Gjermani po shikon nga afër të gjithë futbollistët që ka na dispozicion, teksa në një intervistë për faqen zyrtare të klubit ka folur për merkaton. Flick ka theksuar se në ekip dëshiron lojtarë që kanë ego për të fituar, ndërsa eksperiencia e tyre do të ndihmojë në përmirësimin e futbollistëve të rinj. "Ne duhet të sjellim këtu lojtarë që mund të fitojnë ndeshjet, por kemi edhe futbollistë të rinj që duhet t'i ndihmojmë të përmirësohen", ka deklaruar Flick.

Reus transferohet te LA Galaxy

Skuadra e Major League Soccer, LA Galaxy ka mbyllur transferimin e legjendës së Borussia Dortmund, Marco Reus, sipas Fabrizio Romano. Të dy palët thuhet se kanë zgjidhur detajet përfundimtare, ndërsa mungon vetëm zyrtarizimi. Romano tha "Here we go" e tij, duke bërë të ditur se gjithçka mes LA Galaxy dhe Reus është e përfunduar. Reus, pasi të kalojë te klubi amerikan, do të shtonte një tjetër element sulmues dhe përvojë në një ekip që ka Riqui Puig, Gabriel Pec dhe Joseph Paintsil. Ndërsa ai do të ishte ylli i fundit evropian që do t'i bashkohej MLS, ai nuk është i vetmi që shkon në Los Angeles. Skuadra rivale LAFC nënshkroi me ish-sulmuesin e Milanit, Arsenalit dhe Chelseat, Olivier Giroud.

Juventus dhe Milani në garë për Bojën

Armando Broja vazhdon përgatitjet me Chelsea për sezonin e ri, edhe pse me shumë mundësi karriera e tij pritet të vijojë larg "Stamford Bridge". Për sulmuesin e talentuar të kombëtares shqiptare nuk mungojnë admiruesit në Serie A. Sidomos nga Juventus. Mediat pranë klubit bardhezi raportojnë se Cristiano Giuntoli, CEO i "Zonjës", po tenton një sulmues për të zëvendësuar polakun Milik. I cili është me valixhe gati. Dhe një nga emrat që i pëlqejnë shumë drejtuesit të rekordmenëve të futbollit italian, është pikërisht Armando Broja. Por në listën e Giuntolit bën pjesë edhe Matteo Retegui, sulmuesi i Genoa edhe kombëtares së Italisë. "Është e vërtetë, kam oferta nga Serie A, Bundesliga dhe Premier Ligë. Sigurisht që edhe qëndrimi te Chelsea është një mundësi, pasi ka edhe shumë vite kontratë me klubin", u shpreh disa ditë më parë 22-vjeçari nga Malësia e Madhe. Por jo vetëm Juventus. Pas Brojës qëndron edhe Milani, që nuk ka hequr ende dorë nga ideja e transferimit të "yllit" shqiptar nën urdhrat e Fonseca. Kuqezinjët e duan në huazim, opsion që kundërshtohet për momentin nga Chelsea. Pasi londinezët preferojnë shitjen e plotë të kartonit të Brojës.

Verstappeni përplasat me Red Bullin

BUDAPEST, 22 KORRIK - Kush mendonte se tre titujt kampionë bote në Formula 1 dhe mbi të gjitha 35 fitore në 46 GP-të e fundit e kishin larguar përfundimisht versionin "djali i keq" i Max Verstappen, ka mbetur i befusuar nga gara e fundit në Hungari. Në Budapest kampioni në fuqi i botës dhe lideri i renditjes jo vetëm që pati një ditë të keqe në nivel sportive, u rendit i pesti, por gjatë gjithë garës u shfaq nervoz dhe përplasej me ekipin e tij. Nëse grushti që dha në timon në fund të provave zyrtare shkaktoi polemika, ndjenja e një nervozizmi të madh u përkeqësua edhe gjatë garës. Pas nisjes së garës, Verstappen e gjeti veten në mosmarrëveshje me ekipin, që i tha t'i linte pozicionin Norris, për të shmangur penalitete. Max më pas u nxehtë me inxhinierin e tij të pistës Gianpiero Lambiase, kur iu tha se mund të përdorte "mode 9" për të parakaluar Hamilton. Por, pak minuta më vonë, holandezi kishte kundërshtime për zgjedhjen strategjike për të



mbetur në pistë me goma të konsumuara. "Është mjaft mbresëlënëse që ne vazhdojmë të nënvlerësohemi nga të tjerët. Kjo po shkatërron plotësisht garën time", ka thënë Verstappen përmes radios menjëherë pas ndalesave të hershme të Lewis dhe Charles në pistë. "Ishit ju që ma dhatë këtë strategji të ndyrë m..i. Tani po përpiqem të

rikuperoj atë që ka mbetur", tha më pas Max në radio. Kontakti me Hamilton e tërboi edhe më shumë Verstappen, i bindur se Lewis kishte lëvizur gjatë frenimit dhe që shkaktoi një qortim nga inxhinieri në radio: "Max, nuk do të debatoj në radio me të gjitha ekipet e tjera. Le të vendosin komisarët, po sillësh si fëmijë, Max, si fëmijë!".

Manaj nuk largohet nga Sivaspori

Ishte pritur se Rej Manaj do të largohet nga Sivaspori, pasi shkëlqeu në Superligën e Turqisë. Gjithsesi, sulmuesi i kombëtares shqiptare për momentin nuk ka vendosur të ndryshojë ambient. Ai ka

lajmëruar me një mesazh në "Instagram" se do të kthehet tek skuadra e tij për të nisur fazën përgatitore për edicionin e ardhshëm. Pati shumë zhurmë në fund të majit se Manaj pritej të largohej nga Sivaspori dhe të

shkonte në një ligë tjetër të Evropës, ose të bashkohej me ndonjë gjigand në Turqi si Beshiktashi apo dikush tjetër. Ylli kuqezi pati një kontribut si pak të tjerë në Superligën turke duke shënuar 18 gola, e duke

ndihmuar ekipin të renditej në pjesën e sipërme të klasifikimit. Pasi shënoi 18 herë, Manaj doli shënuesi i tretë më i mirë në elitën turke, pas yjeve Mauro Icardi dhe Edin Xheko, duke merituar atë që quhet Këpuca e

Bronzit. Nuk dihet nëse ai do të vazhdojë sërish karrierën në të njëjtën ekip, apo do të largohet. Sivaspor do të kërkojë mbi 10 milionë euro për kartonin e tij dhe për transferimin ka kohë deri në fund të gushtit.



Datë: 22.07.2024

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-24225 të datës 29.04.2024 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit nr. 03/2024 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092, komisioni përkatës vendosi njëzëri të rishpall:

KONKURIM TË HAPUR Nr.01/2024

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Parcelat kadastrale:

- P-72116035-00151-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3177 m², jepen në shfrytëzim vetë 2349 m², sipas hartës zonale, pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për personat fizik dhe juridik.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OIQ-së (për personat juridik).
3. Dëshmi për obligimet e krycara ndaj ATK- së (për personat juridik).
4. Deklaratë vjetore tatimore nga ATK -ja (Formular vjetor tatimorë për dy vitet e fundit)
5. Garancioni bankar nga banka ose kompanit e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të silltet para nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentët e kërkuara
- Oferta ekonomikisht më e favorshme
- Deklaratë vjetore tatimore nga ATK -ja për 2 (dy) vitet e fundit-**15% të pikëve**
- Vlera e Investimeve konform deklaratave vjetore për dy vitet e fundit --do të vlerësohet për objekt **15% të pikëve**, ndërsa për paisje dhe makineri për veprimtari adekuate **5% të pikëve**.
- Çmimi për m² të parcelës - *minimum 0.05 cent/m² në vit....5% të pikëve*.
- Numri i të punësuarve specifiko pozitat e deklaruara të punëtorëve - *numri i punëtorëve duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve15% të pikëve*
- Lloji i veprimtarisë adekuate.... **20% të pikëve**.
- Plani dinamik- *jo më shumë se 2 vite....15% të pikëve*.
- Projekti Ideor konform Planit të hartës Zonale të Komunës- :**10% të pikëve**.

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria joadekuate do të diskualifikohet nga konkurimi.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **05.08.2024**, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave më datë **05.08.2024** deri në ora **13:30** zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet më **05.08.2024** në ora **14:00** në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.06/L-092.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708 / 049563420
armend.m.krasniqi@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit

Armend KRASNIQI

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

FERMA LONA SH.P.K. me Numer Unik.Biz: 811313791 me seli te biznesit në Adresa: **Keqekoll komuna Prishtine**, po kërkon një ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë / propozim për **mallrat / punët / shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. Traktor me pollug para dhe mbrapa me klime,kabine,
2. Luge e Traktorit,
3. Energjia Solare

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **FERMA LONA SH.P.K. pronare Zyrafete Abaz Xhemaili** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (**5 ditë nga data e publikimit**)

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: **Keqekoll komuna Prishtine**

Për Informata Shtesë tel: **+383 045/680422** dhe në email adresën:

lonaferma@gmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enis Lahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollë së mesme "Arkitekt Sinani".

- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale "Bahri Haxha"-ish shkolla e mesme "Muharrem Bekteshi".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

